

Seminari plotëson kërkesat arsimore për regjistrimin e personave të interesuar në Regjistrin Ndërkombëtar të Inspektorëve të Certifikuar nga IRCA (numër certifikate A17595)

Seminari zhvillon kërkesat e modelit EN ISO 9001:2015 dhe paraqet pregatitjet teknike, udhëheqjen dhe përfundimin e inspektimit, duke e realizuar atë në një kompani virtuale në përputhje me kërkesat e standardit ISO 19011:2011.

I drejtohet inspektorëve të ardhshëm konsulent në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, të cilët zhvillojnë Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, menaxherëve të cilësisë, drejtuesve dhe pronarëve të bizneseve, punonjësve dhe në përgjithësi atyre që duan të përftojnë një njohuri të lartë dhe të integruar në kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë.

Në përfundim të Programit Arsimor, pjesëmarrësit do të jenë të aftë të krijojnë, zhvillojnë dhe aplikojnë Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, në përputhje me standardet EN ISO 9001:2015.

Ky Program Trajnimi është krijuar në mënyrë të tillë që të sigurojë një trajnim gjithëpërfshirës në kërkesat e EN ISO 9001:2015 dhe Auditet e Sistemeve të Menaxhimit në përputhje me standardin EN ISO 9001:2008, në një kohë të shkurtër.

Programi Trajnues mbulon kërkesat e trajnimit nga IRCA, ka si numër certifikimi A17421 dhe përfshin në total 17 aktivitete, nëpërmjet metodave trajnuese interaktive. Manuali ofrohet për pjesëmarrjen në studim në një ditë shtesë (pa pagesë) për ata që nuk kanë informacion më të hershëm rreth standardit.

Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit dhe të provimeve me shkrim, jepet Certifikate nga IRCA për Auditues Udhëheqës dhe pjesëmarrësve që dëshirojnë, u jepet mundësia të marrin pjesë në një inspektim të real. Në rast ngelje të provimit, jepet Certifikatë Pjesëmarrje. Për pjesëmarrësit që kanë ngelur, u jepet mundësia të përsërisin provimin në seminarin pasardhës.